



Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Prizren

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit prek në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e qytetarëve që banojnë në pjesën historike, të komunitetit të biznesit, gjegjësisht artizanëve, lokaleve afariste shërbyese dhe hoteliere, si dhe prek tërthorazi interesat e gjithë qytetarëve të komunës së Prizrenit. Andaj shoqëria civile e Prizrenit rekomandon fuqishëm që, para miratimit të këtij ligji, të organizohet dëgjimi publik, e drejtë e garantuar me legjislacion. Qytetarët e Prizrenit duhen të gëzojnë të drejtën të marrin pjesë në vendimet që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën dhe mirëqenien e tyre. Pas dëgjimit publik dhe marrjes së informacionit kthyes nga qytetarët e Prizrenit, projektligji duhet kthyer sërish në komisionin gjegjës për revidim para se të prezantohet në Kuvendin e Kosovës për miratim.

Shqetësimet

Në nenin 2, pika 1.1. ceken parimet e përgjithshme të cilat janë në rregull: "mbrojtja dhe ruajtja e Qendrës Historike të Prizrenit përfshirë trashëgiminë kulturore dhe natyrore, diversitetin kulturor dhe karakterin tradicional urban të saj".

Projektligji në vijim merret kryesisht me objektet (ndërtesat) e trashëgimisë fetare, me theks të veçantë në objektet fetare të kishës ortodokse serbe. Definicionet për Trashëgiminë Kulturore sipas UNESCO dhe agjensioneve të tjera relevante përfshijnë vlerat materiale dhe jomateriale. Me vlera materiale nënkuptohet materialet e prekshe si godinat, materiali i lëvizshëm arkeologjik, krijimet artistike, dokumentet arkivore, pajisjet tradicionale të punës dhe mjeshtërisë etj. Me vlera jomateriale nënkuptohet folklori gojor i ruajtur në kujtesë dhe i shkruar, folklori vokal, koreografik e instrumental, zakonet dhe doket tradicionale, besimet e traditës, zejet e ndryshme tradicionale etj. Projektligji është i mangët, nuk është i balansuar, dhe merret vetëm me një pjesë teknike të vlerës materiale të trashëgimisë, andaj nuk rregullon fushën e trashëgimisë kulturore në tërësi. Prizreni karakterizohet me vlera jomateriale po aq sa ka edhe vlera materiale.

Rekomandimi: Në vend të "kisha ortodokse serbe" duhet të figurojë vetëm "kisha ortodokse", pasi qyteti i Prizrenit ka një kishë ortodokse shqiptare edhe pse më vonë e përvetësuar si serbe. Për qytetarët e Prizrenit është fyerje e dinjitetit shmangja totale e përdorimit të fjalës "shqiptare" ose të etnive të tjera. Projektligji duhet të rregullojë edhe ruajtjen dhe promovimin e vlerave jomateriale të trashëgimisë kulturore, po ashtu edhe vlerat materiale përveç godinave që ceken.

Neni 3 cek se "Konservimi dhe zhvillimi i Qendrës Historike të Prizrenit bëhet në pajtim me Konventën e UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore".

Konservimi dhe zhvillimi nuk bëhet në pajtim me Konventën e UNESCO-s. Me këtë projektligj konservimi dhe zhvillimi bëhet në mënyrë selektive, sepse Konventa e UNESCO-s përfshin vlera materiale dhe jomateriale të tjera nga të cilat ky projektligj është shmangur. Në projektligj në asnjë vend nuk është cekur fjala turizëm dhe as drejtoria gjegjëse komunale për zhvillim.

Rekomandimi: Pavarësisht strukturës bazë menaxhuese që parashihet me LVL, komuna e Prizrenit ka specifikat e veta që rrisin potencialin për zhvillim ekonomik lokal. Trashëgimia kulturore është ndër të vetmet mjete që rrisin mirëqenien e qytetarëve përmes turizmit, andaj projektligji duhet të rregullojë krijimin e mjedisit të favorshëm për ofrimin e shërbimeve të turizmit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Neni 7, nën arsyetimin e mbrojtjes së strukturës karakteristike urbane, ndalohej "bashkimi i dy apo më shumë parcelave kadastrale në një njësi të vetme" (Neni 7, pika 1.1.).

Nuk mbrohet struktura karakteristike urbane duke ndaluar bashkimin e parcelave kadastrale, por duke kontrolluar ndërtimet në ato parcela. Kjo pikë ngulfatë çfarëdo nisme të qytetarëve të zgjerojnë hapësirën e vendbanimit dhe u mohon të drejtën për të jetuar në një mjedis me hapësirë të mjaftueshme. Po ashtu kjo pikë ngulfatë çfarëdo nisme të bizneseve lokale për të ofruar shërbime të ndryshme përfshirë ato turistike, me çka kufizohet rrënjësisht zhvillimi lokal ekonomik.

Rekomandimi: kjo pikë duhet hequr fare.

Neni 7, pika 2.2. ndalon aktivitetet ndërtimore të ngritjes së objektit të vetëm në dy apo më shumë parcela kadastrale.

Sikur që është cekur edhe më lartë, pronarit të dy ose më shumë parcelave i mohohet e drejta për të ndërtuar objektin e banimit ose afarist në pronën e vet, me çka cenohen një sërë konventash Evropiane dhe të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut.

Rekomandimi: ky nen duhet hequr fare. Në vend të këtij duhet cekur ushtrimin e kontrollit të organeve gjegjëse gjatë ndërtimit për t'iu përmbajtur kritereve dhe standardeve të cekura në këtë projektligj.

Neni 7, pika 1.4. ndalon "aktivitetet ndërtimore apo transformuese ku sipërfaqja e përdhësës nuk do të tejkalojë 150m²".

Është kundërshti e çfarëdo të drejte themelore të njeriut t'i ndalohet adaptimi ose ndërtimi i objektit të banimit në më shumë se 150 m². Edhe në zonën historike të qytetit jetojnë bashkësitë familjare me shumë anëtarë të familjes. Po ashtu, kjo pikë ndalon çfarëdo nisme të operatorëve ekonomikë ose bizneseve familjare të rrisin kapacitetet e veta ose të ndërtojnë objekte të reja me qëllim të zhvillimit të turizmit kulturor. Sipas kësaj logjike edhe Art Qendra nuk duhet ndërtuar fare, dhe fare lehtë të nesërmen mund të inicohet procedurë deri në kushtetuesen për rrënim të saj.

Rekomandimi: ky nen duhet hequr fare. Në vend të këtij duhet cekur ushtrimin e kontrollit të organeve gjegjëse gjatë ndërtimit për t'iu përmbajtur kritereve dhe standardeve duke ruajtur karakterin e Qendrës Historike të cekura në këtë projektligj.

Të dy pikat e nenit 7, nga shoqëria civile perceptohen si kamuflazh i pazotësisë së organeve gjegjëse për të ushtruar kontrollin mbi ndërtimin sipas kritereve dhe standardeve, dhe jep përshtypjen se më lehtë është të ndalohet fare ndërtimi, pavarësisht dëmit që shkaktohet në zhvillim të ekonomisë lokale, se sa të përballen organet gjegjëse në kryerjen e detyrave të tyre. Këto pika paragjykojnë se organet komunale të Prizrenit nuk janë në gjendje të kontrollojnë adaptimet dhe ndërtimet sipas kritereve dhe standardeve, andaj Komuna e Prizrenit nuk duhet t'i lejojë këto pika.

Me Nenin 7, pika 1.6. ndalohet "vendosja e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve penguese me sipërfaqe më të madhe se 1m². Sot në gjithë Qendrën Historike të Prizrenit nuk ekziston asnjë shenjë dalluese më e vogël se 1m².

Rekomandimi: sipërfaqja e shenjës dalluese duhet të shtohet në 2m², ose të ndërrohet "1m²" në "deri në një metër gjatësi".

Neni 8, pika 1.2. ndalon 1.2. "aktivitetet e natyrës komerciale të cilat përfshijnë një sipërfaqe të hapësirës së brendshme më të madhe se 150m²".

Aktivitete të natyrës komerciale nënkuptohet edhe shërbimet hoteliere dhe turistike, përfshirë edhe kafe-lokalet, sipërfaqja e shumë të cilave në këtë zonë kalon 150 m².

Rekomandimi: Në vazhdim të kësaj pike duhen cekur përjashtimet - "Përjashtim bëjnë shërbimet hoteliere dhe turistike, kafe-lokalet dhe supermarketet".

Neni 8, pika 1.5, ndër tjerash, ndalon edhe vendosjen e parkingjeve.

Zona historike e qytetit kap sipërfaqe të madhe dhe karakterizohet me vizita të shumta të jo prizrenasve. Po ashtu nuk duhet harruar se kjo zonë është edhe zonë e banimit individual dhe kolektiv. Parkingjet janë më se të nevojshme në këtë zonë, dhe duhet zgjidhur çështja e vendosjes së

parkingjeve në ato vende ku nuk cenohet pamja e vendeve të trashëgimisë kulturore. Me këtë ligj hiqet e drejta e vendosjes së parkingjeve.

Rekomandim: Fjala "parkingjeve" duhet hequr fare, ose të shtohet "parkingjet lejohen të vendosen në ato vende ku Komuna konsideron se janë funksionale, me lejen paraprake të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve".

Neni 9 përcakton zonën e Kalasë me parcelat kadastrale sipas shtojcës 1.

Kjo zonë duket se nuk është hartuar me kujdes, sepse përfshin edhe një lagje të tërë të vendbanimit, kryesisht të komunitetit serb (pjesa kadastrale 7658).

Rekomandimi: të riformulohet zona e Kalasë, ku zona e vendbanimit individual duhet të hiqet. Po ashtu, në zonën e kalasë, pranë kishës së Shën Shpëtimtarit, gjendet kompleksi i varrezave ortodokse shqiptare, i lënë pas dore dhe nën bagrema. Që nga vitet e 60-ta kjo pjesë është kamufluar për të zhdukur traditën ortodokse shqiptare që kanë jetuar me shekuj në Prizren.

Rekomandimi: Kjo pjesë duhet pastruar nga bagremat, të nxjerret në shesh dhe të mirëmbahet për shkak të rëndësisë së trashëgimisë së qytetit.

Neni 14, pika 2 ndalon hyrjen e "automjeteve të rënda me peshë më të madhe se 3t".

Magjistrerja kryesore Morinë - Prishtinë kalon, përgjatë Lumbardhit, në mes të Qendrës Historike të Prizrenit, përmes së cilës bëhet edhe transporti i mallrave sigurisht me peshë më të madhe se 3t. Po ashtu Qendra Historike e Prizrenit, e kufizuar në zonë sipas shtojcës 1, përfshin edhe banimin individual dhe kolektiv, me çka gjithsesi do të nevojitet transportet eventuale me pesha më të mëdha se 3t. Adaptimet, rindërtimet dhe ndërtimet në këtë zonë gjithashtu do të kenë nevojë për transport të materialeve me peshë mbi 3t.

Rekomandimi: Duhet shtuar përafërsisht pjesa "Transporti i mallrave me peshë mbi 3t lejohet edhe në këtë zonë, në mënyrë të kontrolluar nga organet gjegjëse, në raste që shihet e arsyeshme nga Komuna".

Neni 16 parasheh themelimin e një "Komiteti për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit", të përbërë prej 7 anëtarëve.

Në këtë komitet pritet të zgjidhen tre anëtarë të Shoqërisë Civile e që vijnë nga bashkësitë fetare (pika 1.2). Bashkësitë fetare nuk janë Shoqëri Civile, dhe në procedurë është hartimi i Ligjit për Bashkësitë Fetare. Në mungesë të këtij ligji, të gjitha bashkësitë fetare, pos kishës ortodokse, janë të regjistruara si Organizata Joqeveritare por që nuk veprojnë si të tilla. Shoqëria civile nuk i konsideron bashkësitë fetare pjesë të veten, pasi bashkësitë fetare janë një sferë tjetër e shoqërisë. Gjithashtu përfshirja e Drejtorisë për Zhvillim dhe Turizëm është më se i nevojshëm në këtë komitet, për arsye se përmes kësaj drejtorie përfshihen politikat komunale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal.

Përfshirja e Shoqërisë Civile në këtë komitet është e pamjaftueshme. Pjesëtarë të shoqërisë civile duhen të jenë individë me përvojë në hartimin dhe menaxhimin e projekteve dhe politikave si dhe njohës të fushës së trashëgimisë kulturore.

Rekomandimi 1: rekomandohet fuqishëm që ky ligj të mos miratohet para miratimit të ligjit mbi bashkësitë fetare, ose bashkësitë fetare të përjashtohen nga termi "Shoqëria Civile".

Rekomandimi 2: Komiteti të përbëhet nga nëntë anëtarë - tre të deleguar nga secila Bashkësi Fetare, katër anëtarë të Shoqërisë civile, një anëtar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe një anëtar nga Drejtoria për Zhvillim dhe Turizëm.

Neni 16, pika 2, cek rolin e këtij komiteti, gjegjësisht "Roli i Komitetit është të vëzhgojë dhe këshillojë rreth aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore, dhe i raporton Kuvendit Komunal çdo tre muaj.

Komitetet që kanë vetëm rol vëzhgues dhe këshillues, pa kurrëfarë kompetence të dhënë, janë dëshmuar si të dështuara në Republikën e Kosovës në këto 12 vitet e fundit. E vetmja kompetencë është ajo e kishës ortodokse serbe, e përshkruar më poshtë.

Rekomandimi: Komiteti duhet të ketë kompetencë në ndalimin e dukurive që çojnë në dëmtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore ose në shëmtimin e Qendrës Historike të Prizrenit. Komiteti në rast të prishjes së rendit të zonës së mbrojtur ndërlihet me organet gjegjëse të rendit dhe atyre komunale me çka ata obligohen të veprojnë në parandalimin e prishjes së atij rendi.

Komiteti po ashtu duhet të ketë kompetencë në hartimin dhe aplikimin me projekte në zhvillimore agjencionet e ndryshe donatore ose zhvillimore ndërkombëtare dhe lidhjen e marrëveshjeve në emër të Komunës, me pëlqimin paraprak të saj. Komiteti duhet të ketë të cekur në ligj mënyrën e vendimarrjes lidhur me ushtrimin e kompetencave.

Neni 18 mbi Konsultimin, pika 3, fut Komitetin në konsulencë me palët prona e të cilit preket nga projektet komunale.

Vetëm me rol këshillues, Komiteti nuk duhet lejuar të komunikojë me palët eventuale të pakënaqura dhe të vendos Komitetin në situata të palakmueshme të që mund të jenë të tendosura. Pika 4 e këtij neni cek se "Komiteti duhet të kërkojë pajtimin e Kishës Ortodokse Serbe për çdo aktivitet, i cili prek pronat e Kishës Ortodokse Serbe në Qendrën Historike të Prizrenit në pajtim me Aneksin 5 të Propozimit Gjithëpërfshirës të Zgjidhjes dhe Kushtetutën". Me këtë Aneks pronë e objekteve fetare serbe konsiderohet objekti dhe perimetri në 50 metra. Në disa objekte zona e objektit fetar serb arrin në 100 metra perimetër. Me këtë pikë të gjitha aktivitetet (pavarësisht çfarë aktiviteti është) mbesin peng i dhënies së pëlqimit të kishës ortodokse serbe. Duke pasur parasysh shtrirjen e objekteve fetare serbe dhe perimetrin prej 50 ose 100 metrash, të gjitha aktivitetet që planifikohen në shumicën e zonës Historike të Qytetit të Prizrenit mbesin në vullnet të aprovimit apo jo të atyre aktiviteteve. Kjo pikë konsiderohet fyerje e dinjitetit të qytetarëve prizrenas të cilët nuk do të lejojnë që organet qeverisëse jashtë Republikës së Kosovës të vendosin për aktivitetet që i planifikojnë. Gjithashtu shoqëria civile nuk mund të lejojë aplikimin e kësaj pike. Mbetja e kësaj pikës në këtë ligj do të bëjë këtë të fundit të pazbatueshëm.

Rekomandimi: kjo pikë duhet të hiqet.

Pika 7 është në kundërshti me të gjitha politikat e antikorruptionit, sepse lë hapësirë për të manovruar në dhënien e lejes së ndërtimit. Në asnjë Ligj në botë nuk parashihet qëllimshëm "heshtja administrative" si lejim i ndërtimit.

Rekomandimi: Drejtoria për Urbanizëm i përgjigjet me shkrim, pozitivisht ose negativisht, aplikuesit.

Neni 22 përfshin masat ndëshkuese, ku "Gjobat e parapara me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Ndërtim, dyfishohen në rast të shkeljeve brenda Qendrës Historike të Prizrenit".

Pa u cekur arsyeshmëria e dyfishimit të gjobës, ky dyfishim është shkelje e të drejtave të njeriut.

Rekomandimi: Të hiqet fjala dyfishim - "Gjobat e parapara me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Ndërtim zbatohen në rast të shkeljeve brenda Qendrës Historike të Prizrenit".

Neni 23 parasheh dhënien e pëlqimit për tubime publike nga dy organe: Drejtoria për Shërbime Publike dhe nga Zyra e Qendrës Historike të Prizrenit.

Me këtë shtohen procedurat byrokratike për organizuesit e tubimeve publike me çka vështirësohet menaxhimi i organizimit të tubimit publik.

Rekomandimi: Duhet hequr kompetenca e Zyrës së Qendrës Historike të Prizrenit për dhënie të pëlqimit për tubime publike. Mjafton dhënia e pëlqimit nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 25 parasheh raportin e këtij ligji me ligjet tjera, ku në rast të ndonjë kundërshtie eventuale, ky ligj mbizotëron gjersa dispozitat ligjore të tjera nuk aplikohen.

Ekziston një sërë ligjesh me të cilat ky ligj bie në kundërtënie, filluar nga legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut deri tek dokumentet e ndryshme rregullative komunale. Miratimi i këtij ligji, pa diskutim publik dhe pa kaluar nëpër një komision komunal i themeluar ad hoc për adaptim të këtij ligji, vetëm sa do të jetë barë e Kuvendit Komunal me çka rrezikon të prishë raportin me qytetarët e vet.

Pika 3 thekson mbizotërimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe Kushtetutën. Si dokument i dalë nga Pakoja e Ahtisarit, dhe në fazën e përmbylljes së Pavarësisë së Mbikqyrur, Komuna e Prizrenit nuk ka nevojë të qeveriset edhe me legjislacion të ngurtë që është në fazën e ndërrimit të legjislacionit.

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, pa diskutim paraprak publik dhe pa u adaptuar për vet interesat e qytetarëve të Prizrenit, vetëm sa do ta largojë qeverisjen lokale nga qytetarët e saj duke krijuar situata të cilat nuk mund të jenë të menaxhueshme nga komuna.